Kronikë

Vlorë/ Në kërkim prej 12 orësh, arrestohet 44 vjeçari! Qëlloi me armë zjarri në Selenicë pas një sherri

Një 44 vjeçar i cili ishte në kërkim prej 12 orësh është vendosur në pranga nga policia e Vlorës

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
1 Dhjetor, 15:09 | **Përditesimi: 1 Dhjetor, 15:45**

Share

Vlorë-Një 44 vjeçar i cili ishte në kërkim prej 12 orësh është vendosur në pranga nga policia e Vlorës.

Avni Ferraj në gjendje të dehur ***ka qëlluar me armë zjarri*** në fshatin Brataj të Selenicës mbrëmjen e djeshme (30 nëntor) pas një konflikti të çastit. Për t'iu shpëtuar bluve 44 vjeçari u largua në kodrat e fshatit Brataj

> *"Shërbimet e Stacionit të Policisë Selenicë, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë dhe Forcën Operacionale në DVP Vlorë, pas ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e djeshme, kanë zhvilluar kërkime të pandërprera gjatë gjithë natës, në kushtet e një terreni të vështirë malor dhe të pyllëzuar.*

Sh.com

LEXO EDHE:
Vlora e Shkodra çelin siparin e festave, ndizen dritat! Qytetet 'vishen' me dekorin festiv

> *Si rezultat, sot në mesditë, në kodrat e fshatit Brataj, u bë i mundur arrestimi në flagrancë i shtetasit A. F., 44 vjeç, banues në fshatin Brataj. 44-vjeçari, mbrëmjen e djeshme, në gjendje të dehur dhe pas një konflikti të çastit, si dhe me pretendimin se disa të mitur po e bezdisnin, ka shkuar në banesë, ka marrë armën e zjarrit dhe ka qëlluar në ajër, duke krijuar panik te banorët dhe te të miturit", informoi sot policia.*

Në momentin e arrestimit, Policia gjeti dhe sekuestroi armën e zjarrit kallashnikov, me fishek në fole gati për qitje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Vlorë selenicë Arrestime Avni Ferraj

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM
Sondazhi i ditës:
28 Nëntor, 09:20
A e keni të qartë pse opozita organizon mosbindje civile?
Po Jo Deri diku

Lajme të tjera

Vlorë, rritet vlera e tokave pranë aeroportit të ri ndërkombëtar, hapet verën e ardhshme! Agjenti imobiliar: Biznesmenët kërkojnë të investojnë

Armand Xhelili

1 Dhjetor, 16:03

Ktheu shtëpinë në bazë për prodhimin e vajit të kanabisit, në pranga i riu në Sarandë! VIDEO si fshehu kallashin brenda në valixhe, i sekuestrohen edhe thikë e fishekë

1 Dhjetor, 10:27



44-vjeçari qëllon me armë zjarri në Selenicë pas një sherri, shpallet në kërkim (VIDEO)

1 Dhjetor, 07:10

Vlorë/ Ra nga kati i 3 i pallatit në ndërtim, punëtori 30-vjeçar ndërron jetë pas 9 ditësh në spital

29 Nëntor, 17:04

Tiranë/ Lojëra fati dhe baste sportive të paligjshme, 6 në pranga! Një 17-vjeçar në hetim

29 Nëntor, 13:20

29 Nëntori/ Homazhe në varrezat e dëshmorëve në qytete! Në Shkodër idhtarët e Komunizmit vendosin yllin, kujtojnë Enver Hoxhën

29 Nëntor, 11:21

Vau i Dejës/ Shkolla u kthye në shtëpi bari, arrestohet elektricisti i zonës, hetohen dhe 3 punonjës të OSHEE-së! Nuk dihen pronarët (VIDEO)

29 Nëntor, 10:07

Raporti për klimën i Bankës Botërore: Diversifikimi dhe potenciali i erës do të bënin TEC Vlorën jo ekonomik përtej 2030

29 Nëntor, 07:39

Festat e nëntorit/ Shqiptarë e të huaj mbushin hotelet! Tirana, Vlora e Korça më të preferuarat

28 Nëntor, 20:34

Festa e Pavarësisë/ Shkrihen 'akujt', Rama dhe Kurti qëndrojnë krah për krah në Vlorë dhe të qeshur (VIDEO)

28 Nëntor, 19:40

Dita e Pavarësisë/ Berisha i lirë, por rri në shtëpi! Në Vlorë shkojnë deputetët

28 Nëntor, 15:43

Vlorë/ Rama inspekton punimet në Qendrën Multifunksionale dhe Aeroportin e ri: Ambicie të mikpresim ajkën e inovacionit! Punë ditë-natë, natë-ditë

28 Nëntor, 15:00

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje